



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 216

Tiranë – E premte, 11 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Kuvendit
nr. 74/2020, datë 3.12.2020

Për miratimin e përbërjes së komisionit të posaçëm “Për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues për gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri, për çështjet e raportit të anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, *Dick Marty*, për bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë”, ngritur me vendimin nr. 71/2020 të Kuvendit.....

16601

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 951, datë 2.12.2020

Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Pedologjia”.

16601

Udhëzim i ministrit të Arsimit,
Sportit dhe Rinisë nr. 26,
datë 7.12.2020

Për një ndryshim në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar.....

16720



VENDIM
Nr. 74/2020

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT TË POSAÇËM “PËR ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE HARTIMIN E NJË RAPORTI PËRMBLEDHËS DHE INFORMUES PËR GJETJET DHE KONKLuzionET QË KANË NXJERRË VERIFIKIMET E KRYERA NGA INSTITUCIONET PËRKATËSE NË SHQIPËRI, PËR ÇËSHTJET E RAPORTIT TË ANËTARIT TË ASAMBLESE PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS, *DICK MARTY*, PËR BASHKËPUNIMIN DHE ROLIN PËR TË CILIN PRETENDOHET SE KANË LUAJTUR PËRFAQËSUES POLITIKË SHQIPTARË OSE INSTITUCIONE PUBLIKE SHQIPTARE, NËPËRMJET VEPRIMEVE DHE MOSVEPRIMEVE, NË NDIHMË TË SË ASHTUQUAJTURËS VEPRIMTARI KRIMINALE E DREJTUESVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NGRITUR ME VENDIMIN NR. 71/2020 TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 24, pika 3, dhe 55, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e komisionit të posaçëm “Për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues për gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri, për çështjet e raportit të anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, *Dick Marty*, për bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare,

nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë”, ngritur me vendimin nr. 71/2020 të Kuvendit është si më poshtë:

1. Ulsi Manja	kryetar	(Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)
2. Enver Roshi	zëvendëskryetar	(Grupi Parlamentar “I pavarur”)
3. Klotilda Bushka	sekretare	(Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)
4. Ermonela Felaj	anëtare	(Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)
5. Alket Hyseni	anëtar	(Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)
6. Adnor Shameti	anëtar	(Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste)
7. Edmond Stojku	anëtar	(Grupi Parlamentar “Demokraci dhe Drejtësi”)
8. Myslim Murrizi	anëtar	(Grupi Parlamentar “Demokrat”)
9. Elena Xhina	anëtar	(Jashtë grupeve parlamentare)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 3.12.2020.

VENDIM
Nr. 951, datë 2.12.2020

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR NË SHQIPËRI – TEMA: PEDOLOGJIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “ll”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit



gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Pedologjia”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin e përditësimin e të dhënave gjeohapësimore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**STANDARDET SHTETËRORE
PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË
SHQIPËRI – TEMA: PEDOLOGJIA**

PËRMBAJTJA

1.PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

2.HYRJE

2.1 Qëllimi

2.2 Si lexohet dokumenti

2.3 Detyrimet ligjore

2.4 Fusha e veprimtimit

3. TEMA

3.1 Pedologjia

3.1.1 Parathënie

3.1.2 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për temën “Pedologjia”

3.1.3 Katalogu i tipologjisë

3.1.3.1 Lloji WRB i emërtimeve të tokës

3.1.3.2 Elementi i profilit

3.1.3.3 Llojet e simboleve të horizonteve FAO

3.1.3.4 Llojet e tjera të emërtimeve të tokës

3.1.3.5 Llojet e tjera të simboleve të horizonteve

3.1.3.6 Lloji i fraksionit të madhësisë së grimcave

3.1.3.7 Lloji i intervalit

3.1.3.8 Lloji i parametrave të tokës

3.1.3.9 Lloji i parametrave përshkrues të tokës

3.1.3.10 Mbulimi i tokës

3.1.3.11 Horizonti i tokës

3.1.3.12 Objekti derivues i tokës

3.1.3.13 Prania e profilit derivues në trupin e tokës

3.1.3.14 Profili derivues i tokës

3.1.3.15 Llojet e grupeve kualifikuese WRB

3.1.3.16 Profili i vëzhguar i tokës

3.1.3.17 Profili i tokës

3.1.3.18 Përshkrimi i mbulimit të tokës

3.1.3.19 Shtresa e tokës

3.1.3.20 Ngastër toke

3.1.3.21 Sit toke

3.1.3.22 Trup toke

3.1.3.23 Vlerat e emërtimeve të parametrave të elementeve të profilit

3.1.3.24 Vlerat e emërtimeve të parametrave të objekteve derivuese të tokës

3.1.3.25 Vlerat e emërtimeve të parametrave të profilit të tokës

3.1.3.26 Vlerat e emërtimeve të parametrave të siteve të tokës

3.1.3.27 Vlerat e gjendjes së procesit të gjenezës në shtresa

3.1.3.28 Vlerat e llojeve të shtresave

3.1.3.29 Vlerat e llojeve të ngastrave të tokës

3.1.3.30 Vlerat e llojeve të tjera të emërtimeve të tokës

3.1.3.31 Vlerat e llojeve të tjera të simboleve të horizontit

3.1.3.32 Vlerat e pozicioneve kualifikuese WRB

3.1.3.33 Vlerat e qëllimit të vëzhgimit të tokës

3.1.3.34 Vlerat kryesore FAO të horizonteve

3.1.3.35 Vlerat kualifikuese WRB

3.1.3.36 Vlerat primare FAO

3.1.3.37 Vlerat përcaktuese WRB

3.1.3.38 Vlerat referencë të grupeve të tokës

3.1.3.39 Vlerat vartëse FAO të horizonteve

3.2 Metadata

3.3 Kodi EPSG për KRGJSH-në

3.4 Cilësia e të dhënave

3.4.1 Kompletimi – përjashtimi (*Completeness – Omission*)

3.4.2 Përputhja ligjore – përputhja konceptuale (*Logical consistency – Conceptual consistency*)

3.4.3. Përputhja ligjore – përputhja në *domein* (*Logical consistency – Domain consistency*)

4. ANEKSE

4.1 Aneksi A – Katalogu i tipologjisë

4.2 Aneksi B – Kodlistat

4.2.1 Skema e aplikimit për temën “Pedologjia”
4.2.1.1 Vlerat e gjendjes së procesit të gjenezës në shtresa

4.2.1.2 Vlerat e llojeve të shtresave

4.2.1.3 Vlerat e emërtimeve të parametrave të elementeve të profilit

4.2.1.4 Vlerat e emërtimeve të parametrave të objekteve derivues të tokës

4.2.1.5 Vlerat e qëllimit të vëzhgimit të tokës

4.2.1.6 Vlerat e llojeve të ngastrave të tokës



- 4.2.1.7 Vlerat e emërtimeve të parametrave të profilit të tokës
- 4.2.1.8 Vlerat e emërtimeve të parametrave të siteve të tokës
- 4.2.1.9 Vlerat e pozicioneve kualifikuese WRB
- 4.2.1.10 Vlerat kualifikuese WRB
- 4.2.1.11 Vlerat referencë të grupeve të tokës
- 4.2.1.12 Vlerat përcaktuese WRB

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), e cila është autoritet publik përgjegjës për temën “Pedologjia”.

Data e publikimit të versionit nr. 1, është prill 2019. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSIDI_2019_PED_v.1, ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit;

Standard – Lloji i dokumentit;

NSDI – Qëllimi i dokumentit;

2019– Viti i krijimit;

PED– Tema për të cilën është krijuar standardi: “Pedologjia”, e cila i referohet temës “Soil” në direktivën INSPIRE;

v.1 – Numri i versionit të standardit.

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, të harmonizuara konform direktivës INSPIRE, për të dhënat gjeohapësinore të temës “Pedologjia”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/II, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen përpunimin dhe përditësimin e informacionit

gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë e tyre.

2.2 Si lexohet dokumenti

2.2.1 Struktura e dokumentit

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. **Përshkrimi i standardeve:** në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. **Hyrje:** në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

3. **Tema:** në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Pedologjia”.

4. **Anekse:** në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve. Gjithashtu jepen të detajuara edhe vlerat e kodlistave.

- Përmbajtja e kapitullit III është strukturuar në 4 pjesë kryesore:

3.1 **Përshkrimi i temës:** këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës, si dhe mënyrën e konceptimit të temës, duke e detajuar me: Diagramet UML dhe Katalogun e tipologjive.

3.2 **Metadata:** këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.1 **Sistemi Koordinativ Referencë** – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë që është miratuar me vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 27.4.2016 dhe nr. 359, datë 29.5.2019.

3.2 **Cilësia e të dhënave:** këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 Diagramet UML dhe katalogu i tipologjisë

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në Katalogun e tipologjive (*Feature Catalogue*). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i Tipologjive, mund të jetë

¹NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.



i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një Shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kod-listës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	Tipi i elementit mund të jetë i llojit: «featureType» -një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte; «dataType» - një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë attributesh, për t'u lidhur me një element tjetër; «enumeration» «<i>CodeList</i>» -listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codelist</i> nënkupton listë vlerash ose ndryshe “kodlistë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kodlistat”; «union» - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet që bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të dy grupeve të të dhënave hyrëse; «Imported» - të dhëna të specifikuar në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden “Të dhënat e importuara”
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon. Abstrakt - kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..*- mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë; 1..*- mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera; 0..1- mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme; 1- duhet të marrë detyruesisht 1 vlerë.
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet; Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet.
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol shoqërimi” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.
Atributet	« Attribute » - janë informacione të bashkëngjitura në format tabelor të tipologjitë gjeohapësinore.



Tabela 2

ATRIBUTET

-- Emri --

Emërtimi i atributit

-- Përkufizimi --

Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE, i elementeve.

-- Përshkrimi --

Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin

[I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET

♦ Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: *Ligjor*

-- Emri --

Emërtimi i vlerës

-- Përkufizimi --

Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve.

♦ Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh: *Joligjor*

-- Emri --

Emërtimi i vlerës

-- Përkufizimi --

Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE, i elementeve.

2.2.3 karakteristikat e *voidable* dhe shumëllojshmëria

Stereotipi ‘*voidable*’ përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në realitet. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t’u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera ‘*void*’. Një vlerë *void* nënkupton se nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës *void* duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArsyesSëPavlefshmërisë* (*VoidReasonValue*), e cila përmban:

- E panjohur (*Unknown*)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujon nga niveli i detit” e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “E panjohur”.

- E papopulluar (*Unpopulated*)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujon nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “E papopulluar”.

-- Konfidenciale (*Withheld*).

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull: Të dhënat personale të popullsisë të cilat ekzistojnë por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi 'voidable' nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në realitet. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4 Mbulimet - Coverages

Funksionet e mbulimit 'Coverages' përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohoro-gjeohapësinor. *Domein*-et tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si vetitë e llojeve të objekteve gjeohapësinore ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është një realizim i një prej llojeve të specifikuar në SSH EN ISO 19123:2007.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh. ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndër tematik për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptual të Përgjithshëm "*Generic Conceptual Model*".

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *RrjetiIMbulimitIKorrigjuar* (rektifikuar): Mbulimi, *domein*-i i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 1, majtas).

- *RrjetiIMbulimitReferencë*: Mbulimi, *domein*-i i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje të mbulimit (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.




Figura 1: Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)



2.2.5 Numërtimet dhe kodlistat (Enumeration and code list)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistë, 'vlera të tjera' përcaktojnë llojin e përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht, si më poshtë:

- 'jo' përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuar në këtë dokument;
- 'të kufizuara' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;
- 'të hapura' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave;
- 'po' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera "jo", pra të specifikuar në dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 Paraqitja e dimensionit kohor

Skemat e aplikimit përdorin atributin "FillimiICiklitJetësor" dhe "PërfundimiICiklitJetësor" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi "FillimiICiklitJetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi "PërfundimiICiklitJetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në realitet.

Ndryshimet që bëhen në atributin "PërfundimiICiklitJetësor" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "FillimiICiklitJetësor".

❖ Shënim i rëndësishëm:

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. featureType, dataType, void, coverages etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të direktivës INSPIRE.

2.3 Detyrimet ligjore

Në bazë të ligjit nr. 72/2012, neni 16, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", ASIG-u është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore, për krijimin e NSDI-së në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë (VKM-ja nr. 1077, datë 23.12.2015);

- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 Fusha e veprimit

Të gjithë autoritetet publike, kompanitë private apo individët që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave;

Vlerësimi – është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit;

Procesimi (përpunimi) – është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar;

Shpërndarja – është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit;

Zbulimi – është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jociësore në të dhënat e publikuara;

Analiza – është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë

këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara;

Arkivimi – është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike;

Shkatërrimi – është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacionin në fuqi.

3. TEMA

3.1 Pedologjia

3.1.1 Parathënie

Pedologjia (tema e të dhënave gjeohapësinore që përshkruan të dhënat për dheun/tokën) është pjesa e sipërme e kores së tokës, e formuar nga grimca minerale, lënda organike, uji, ajri dhe organizma të gjallë. Ajo karakterizohet nga thellësia, tekstura, struktura dhe procese si: gërryerja, erozioni etj.



Tema “Pedologjia”, përfshin:

1. Inventarin i tokës – siguron një vlerësim të kushteve dhe/ose vetive të tokës në një vend dhe kohë të caktuar dhe lejon monitorimin e tokës, duke siguruar një sërë vlerësimesh që tregojnë se si ndryshojnë kushtet dhe/ose tiparet e tokës me kalimin e kohës.

2. Hartografinë e tokës – siguron një prezantim gjeohapësinor të tipareve të lidhura me tokën, të cilat përfshijnë llojet e tokës; veçanërisht, hartat e tokës që realizohen me ndihmën e të dhënave të disponueshme nga inventarët e tokës. Gjithashtu informacione të tjera të lidhura me tokën që rrjedhin nga vetitë e saj, në kombinim me të dhëna jotokësore që janë brenda fushëveprimit.

Modeli i të dhënave për temën “Pedologjia” përcakton rastet e përdorimit të të dhënave që përfshijnë:

- treguesit agromjedisorë;
- hartat tematike që rrjedhin nga informacionet për tokën;
- zonat e kontaminuara;
- monitorimin e tokës.

Modeli i të dhënave përmban një grup thelbësor të *feature*-ve të objekteve gjeohapësinore dhe attributeve të tyre që konsiderohen si thelbësore për infrastrukturën, përkatësisht së cilës mund të shkëmbehen të dhënat mbi tokën. Përveç modelit bazë të të dhënave të tokës, modeli i të dhënave shtesë (duke përfshirë skemën e aplikimit) merret me menaxhimin e ndotjes së tokës. Ky model shtesë tregon se si modeli bazë i të dhënave të tokës mund të zgjerohet për të përfshirë kërkesa më specifike (kontaminimi i tokës) të identifikuar nga rastet e përdorimit.

Përkufizimi:

Toka dhe nëntoka karakterizohen sipas thellësisë, teksturës, strukturës dhe përmbajtjes së grimcave, lëndës organike, përmbajtjes së gurëve, erozionit, ku përcaktohet pjerrësia mesatare e përshtatshme dhe kapaciteti i parashikuar i magazinimit të ujit.

Përshkrimi:

Tema “Pedologjia” trajton dheun/tokën, e cila është një burim jo i rinovueshëm, si e tillë ajo është e cenuar nga procese të ndryshme si degradimi, ndryshimet klimaterike, rrëshqitjet, përmytjet etj. Procesi i degradimit të tokës, ndikon në kontaminimin e saj dhe si pasojë toka nuk përdoret më për prodhim ushqimor, duke u kthyer në rrezik

për shëndetin njerëzor/ekologjik. Gjithashtu, ndryshimi i klimës ka sjell nevojën që toka të kryej zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimaterike.

Përveç procese të lartpërmendura, toka cenohet dhe nga procese të tjera, si: erozioni, rënia e sasisë së lëndës organike, kontaminimi, kripëzimi, sodifikimi (procesi me të cilin rritet përmbajtja e shkëmbyeshme e natriumit të tokës), kompaktësimi, humbja e biodiversitetit të tokës, hermetizimi (procesi i bashkimit kompakt dhe përfundimtar), rrëshqitjet e tokës dhe përmytjet. Gjithashtu, acidifikimi i tokës në përgjithësi konsiderohet të jetë një problem në zonat e lagështa.

Informacioni mbi tokën është i nevojshëm për të marrë vendime themelore për mbrojtjen e tokës nga proceset e degradimit.

Duke pasur informacione në lidhje me tokën mund të përmirësohet prodhimi bujqësor dhe pyjor, mund të parandalohet dëmtimi i mjedisit nga aktivitete njerëzore, mbajtja nën kontroll e zonave të kontaminuara etj. Ekziston një kërkesë e lartë informacioni për tokën, në lidhje me reduktimin e karbonit (ndryshimet klimatike), mbrojtjen e tokës nga degradimi, përmirësimin e prodhimit bujqësor (p.sh. kulturat që përdoren për ushqime dhe për bioenergjia) dhe për zbutjen e shkretëtirëzimit në zonat me sipërfaqe të thatë dhe gjysmë të thatë.

Rastet e përdorimit

Informacionet (të dhënat) në lidhje me tokën, përdoren nga shumë fushëveprime të tjera, të radhitura më poshtë:

1. Treguesit agromjedisorë:

- përdorimi i treguesit mjedisor të erozionit të tokës;
- përdorimi i treguesit mjedisor të cilësisë së tokës;
- përdorimi i treguesit mjedisor të zonave të kontaminuara.

2. Krijimi i hartave tematike nga informacioni i tokës:

- përshtatshmëria e tokës për ujtit;
- zhvillimi i metodologjive për monitorimin e kripëzimit të tokës;
- monitorimi i projektit të burimeve bujqësore;
- kufizimet për Azotin (N) dhe Fosforin (P) në bujqësi;
- përcaktimi i kufijve për metalet e rënda;
- përdorimi për të vëzhguar shkallën e ndryshimeve të tokës;

- përcaktimin e zonave më pak të favorshme.

3. Zonat e kontaminuara:

- regjistrin e tokave të kontaminuara;

- përdorimin e ujit të pijshëm dhe kontaminimin e tokës;

- përdorimi ekologjik dhe kontaminimi.

4. Monitorimi i tokës:

- paraqitja e gjendjes së tokës.

Bazuar në rastet e përdorimit u identifikuan përdorimet përkatëse dhe të përgjithshme për informacionin e tokës:

- Për përdorimin e informacionit gjeohapësinor të tokës, nevojiten të dhëna që lejojnë krijimin e hartave (në shkallë të ndryshme) mbi shpërndarjen e llojeve të tokës dhe karakteristikave të saj. Këto të dhëna, bazohen në të dhëna të marra nga profilet e tokës, vëzhgimet dhe mostrat e saj, të cilat të kombinuara me ekspertizën njerëzore dhe/ose procedurat e automatizuara mund të interpretohen në mënyrë të tillë që zonat fizike reale, të cilat tregojnë karakteristika të caktuara të tokës, mund të paraqesin në varësi të shkallës, trupa tokësor. Për këtë arsye përfshihen strukturimi i të dhënave të tokës dhe mundësia për hartëzimin e tyre;

- Karakteristikat e rëndësishme të tokës (p.sh. përmbajtja e karbonit organik, aciditeti i tokës etj.) mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Prandaj detyrohemi të kryejmë monitorim të tokës, për të evidencuar ndryshimet në lidhje me kohën;

- Kontaminimi i tokës konsiderohet si një nga kërcënimet më të mëdha për tokën, në shkallë lokale (zonat e kontaminuara); në shkallë të gjerë të zonës (shpërndarja e ndotjes së tokës, në ujërat nëntokësore dhe praktikrat bujqësore).

Temat “*Pedologjia*” dhe “*Gjeologjia*” trajtojnë objekte të njëjta në realitet, por që kanë perspektiva të ndryshme. Për zonën e tokës, shkëmbi është materiali mëmë i çdo zhvillimi të tokës, dhe si shtresa të tilla gjeogjenike përfshihet në skedarët e të dhënave të tokës. Sidoqoftë, llojet e shkëmbinjve dhe gjenezat e tyre mund të përmenden në të njëjtën mënyrë si në fushën e *Gjeologjisë*. Prandaj, kodlistat për të karakterizuar litologjinë, proceset dhe mjediset e procesit janë të trajtuara në temën “*Gjeologjia*”. Ndërsa shtresat e ngastrave në të cilat zhvillohen tokat nuk konsiderohen në të dhënat gjeologjike, sepse trajtohen në temën “*Pedologjia*”.




Figura 3: Fushëveprimi i Pedologjisë në lidhje me Gjeologjinë

Tema “*Pedologjia*” përfshin fenomenet e mëposhtme:

- profilet e tokës;
- sitet e tokës, ngastrat e tokës;
- trupat e tokës (zonat e përcaktuara në ngastrat e tokës në bazë të karakteristikave të caktuara të tokës);
- karakteristikat e tokës (parametrat) që ndryshojnë me kalimin e kohës (ndoshta duke lejuar monitorimin e tokës).

Duke marrë parasysh këto dukuri të lidhura me tokën, një model është ndërtuar në formën e një diagrami të klasës UML. Shkëmbimi i informacionit i strukturuar sipas këtij modeli, me origjinë nga ofruesit e ndryshëm, do të jetë me strukturë ndërvepruese dhe do të sigurojë një mënyrë të mundshme për shkëmbimin e informacionit të tokës. Në vijim, përshkruhet strukturimi i elementeve dhe koncepteve të fushës së *Pedologjisë* si *feature*-at dhe atributet. Duhet të theksohet se janë marrë në konsideratë shumë elemente bazë të të dhënave gjeografike evropiane të tokës dhe iniciativat e tjera ndërkombëtare në lidhje me standardizimin dhe shkëmbimin e të dhënave të tokës.




Figura 4: Shtresa e profilin të tokës dhe horizonti i vendosur në një komplot toke

Profilet e tokës

Në realitet, koncepti i profilin të tokës (klasa e *ProfilinTëTokës* në model) (ilustruar nga figura 4) mund të përkufizohet si një prerje tërthore e tokës nga sipërfaqja deri në thellësi, duke përfshirë fillimin e materialit të freskët të pa ndikuar nga pedogjeneza, që përbëhet nga karakteristika të ndryshme, më shumë ose më pak të orientuara horizontalisht, të formuara nga proceset pedogjene quhen horizonte. Çdo profil toke mund të karakterizohet nga një numër vetish të tilla si: lloji i tokës sipas një skeme të klasifikimit të tokës, kapaciteti ujëmbajtës i disponueshëm për bimët, mbulimi i fragmenteve të copëtuar, prezenca e ujërave nëntokësorë etj. Horizonti i tokës brenda një profilin, zotëron karakteristika biologjike, fizike dhe kimike që ndryshojnë nga horizontet lart - poshtë dhe dallohen kryesisht nga tekstura, ngjyra, struktura, përbërësit kimikë dhe biomasa e tyre. Vetitë kimike mund të përfshijnë përqendrime në fazat: e ngurtë, e lëngët, e gaztë, lëvizshmërinë dhe kapacitetet e absorbimit të tokës. Një profil mund të përshkruhet gjithashtu me shtresa (në vend që të përshkruhet me horizonte), të cilat jo domosdoshmërisht korrespondojnë me horizontet të formuara gjatë procesit pedogjenetik. Shtresa të tilla mund të jenë intervale fikse, të marrjes së mostrave, horizonte të sipërme dhe të poshtme ose

shtresa gjeogjene. Të dyja si shtresat dhe horizontet janë konsideruar si elemente të profilit, pasi ato të dyja janë nënndarje horizontale të profilit të tokës.

Në realitet, përshkrimi i profilit të tokës (*Përshkrimi i Profilit të Tokës*) përfaqëson një profil toke i cili është i lokalizuar fizikisht në një ngastër, i përshkruar në fushë, dhe me shumë mundësi janë marrë dhe analizuar në laborator. Një profil i përshkruar i tokës i referohet një vendndodhjeje reale (e specifikuar nga një hartë e bashkuar për tokën).




Figura 5: Profilet e tokës, trupat e tokës



Profili derivues i tokës (*ProfiliDerivuesITokës*) është një profil që nuk mund të gjendet në një ngastër toke. Ai korrespondon me shtrirjen gjeohapësinore të tipit të tokës, që është vërejtur në një ose disa profile të tokës. *ProfiliDerivuesITokës* ka vlera të karakteristikave që mund të rrjedhin (p.sh. mesatarisht) nga vlerat e vetive përkatëse të një ose më shumë profileve të tokës të përshkruar. *ProfiliDerivuesITokës* mund të karakterizohet nga të njëjtat cilësi si ato të profileve të vëzhguara të tokës, por kuptohet që vlerat për këto veti janë nxjerrë ose përcaktuar nga gjykimi apo llogaritja e ekspertit. Profili derivues i tokës nuk lidhet domosdoshmërisht me profilet e përshkruara të tokës, në këtë rast ai paraqet një profil të tokës hipotetik.

Zonimi i tokës

Për të përpiluar në mënyrë gjeohapësinore një zonë që është karakterizuar nga një grup i tillë i profileve të tokës së derivuar, modeli paraqet konstruktin e trupit të tokës (*TrupiTokësor*) i cili përfaqëson një bashkim (ose tipa të tjera të ndërlidhjes gjeohapësinore të tipave të ndryshme të tokës) të tipave të ndryshme të tokës që janë gjetur në një zonë. Tokat që formojnë trupin tokësor janë përshkruar duke përdorur profilet e tokës të derivuara, ku për të paraqitur karakteristikat e *TrupitTokësor* përdoren një ose më shumë profile të derivuara të tokës. Modelimi bëhet duke lidhur profilet derivues të tokës me trupin e tokës, që tregon se ku ndahen zonat midis tyre, e shprehur në përqindje (%). Duhet pasur parasysh se vendndodhja e saktë e secilit tip toke brenda një trupi tokësor është e panjohur, vetëm zona (*Gjeometria*) e trupit tokësor është e njohur dhe gjithashtu sa nga kjo ngastër është e mbuluar nga secili tip toke (e paraqitur si profil toke i derivuar).

Për shembull, një trup toke mund të përbëhet nga një tokë dominuese (siç përshkruhet nga një profil derivues toke), dhe nga tipa të tjera toke që kanë karakteristika të ndryshme nga ato dominuese. Emërtimi i një trupi të tokës mundëson përshkrimin e tij, i cili mund të jetë i dobishëm për ndërtimin e legjendave. Një trup tokësor mund të interpretohet si njësi e përpiluar toke siç njihet në bazën e të dhënave gjeografike të tokës Evropiane dhe bazat e të dhënave të tjera të tokës në nivel kombëtar ose rajonal.

Në kontekstin e modelit, një objekt derivues i tokës është përcaktuar si një objekt gjeohapësinor që përfaqëson një karakteristikë të lidhur me tokën, vlera e të cilës mund të rrjedhë; për shembull, nga vlerat e vetive të tokës në lidhje me profilet e vëzhguara të tokës, dhe/ose trupi përkatës i tokës.

Gjithashtu mund të jetë e mundur edhe një vlerë krejtësisht e pavarur nga profili i derivuar i tokës dhe trupi i tokës. Në praktikë, marrja e vlerave për objektet e derivuara të tokës mund të bëhet nga informacioni i ruajtur në profilet e vëzhguara të tokës dhe/ose trupat e tokës, ose nga kombinimi me informacione të jashtme. Një shembull, mund të jetë llogaritja e pH ose përmbajtja e lëndës organike të tokës në horizontin e sipërm, bazuar në të dhënat e gjetura në një sërë profilesh të vëzhguara të tokës. Një shembull i kësaj të fundit mund të jetë nxjerrja e disa karakteristikave të lidhura me tokën (për shembull rreziku i erozionit të tokës), për të cilat do të përdoren modele të kalibruara, të cilat nxjerrin dhe përpunojnë informacione nga profilet e tokës, dhe/ose trupat e tokës, që janë jashtë modelit të tokës (p.sh. të dhënat e mbulimit të meteorologjisë dhe tokës).

Sit toke dhe ngastër toke

Siti i tokës (*SitToke*) konsiderohet pjesa më e afërt e një profili toke dhe/ose pjesa më e madhe e tokës që lidhet drejtpërsëdrejti dhe përshkruhet nga të gjitha vëzhgimet e tokës në një ose më shumë pika të quajtura komplete të tokës.

Ngastra e tokës (*NgastrToke*) është vendndodhja e një vëzhgimi specifik të tokës (p.sh. një gropë prove). Pasi për shumë kërkues, toka e studiuar shkatërrohet, vendi i tokës siguron gjithashtu objektin në të cilin rezultatet e kërkimeve të përsëritura lidhen dhe trajtohen sikur të ishin marrë nga vendi i njëjtë. Qëllimi i kërkimit mund të ketë natyrë të përgjithshme (p.sh. një zbulim me anë të të cilit marrin profilet e tokës për një karakterizim të përgjithshëm të tokës) ose specifike (p.sh. një zbulim me anë të të cilit merren mostrat për të investiguar tokën potencialisht të kontaminuar); ky informacion mund të jetë i rëndësishëm për vlerësimin e të dhënave, për të identifikuar anshmërinë në zgjedhjen e vendeve. Një ngastër toke brenda një siti toke është i një lloji të caktuar (pus, profil, prove, mostër) dhe gjendet nga koordinatat dhe/ose emri, vendndodhja.



Karakteristikat e tokës që ndryshojnë me kalimin e kohës

Nuk ka udhëzime të qarta, të parashikuara lidhur me monitorimin e tokës. Monitorimi, i konsideruar si vëzhgim i përsëritur i një ose më shumë karakteristikave të tokës me kalimin e kohës, mund të zbatohet përmes përdorimit të attributeve të ndryshme të kohës/datës së objekteve të modelit.

Kontaminimi i tokës

Kontaminimi përcaktohet në mënyrë të qartë duke specifikuar parametrat e kontaminimit për zonat, profilet dhe elementet e profilin. Kontaminuesit në këtë rast janë trajtuar si elemente kimikë. Gjithashtu nuk ka udhëzime të qarta të përfshira në modelin për zonat e kontaminuara. Megjithatë, disa elemente të metaleve të rënda janë pjesë e kodlistës për parametrat e elementit të profilin.

Marrja e mostrave të tokës

Në kontekstin e tokës, janë përdorur dy përcaktime të ndryshme për “mostër”: Nga njëra anë termi “mostër toke”, i konsideruar si një pjesë fizike e tokës për të cilën përcaktohet një ose më shumë karakteristika. Nga ana tjetër “mostër” konsiderohet të jetë vendi ku materiali i tokës është marrë në një thellësi specifike ose mbi një gamë të thellë pa bërë ndonjë përshkrim të profilin të tokës. “Mostër”, së bashku me gropën e provës dhe pusëtën, është një lloj kompleti tokësor. Ky i fundit është koncepti i përshkruar në model.

3.1.2 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për temën: “Pedologjia”

Modeli konceptual i temës “Pedologjia”, përmban elementet thelbësore të një modeli të dhënash që lejojnë shkëmbimin e të dhënave të gjeoreferencuara të tokës.

Llojet kryesore të objekteve gjeohapësinore që mund të dallohen në modelin e të dhënave të Pedologjisë janë:

- Profili i tokës (përfshirë *ProfiliIVëzhguarITokës* dhe *ProfiliIDerivuarITokës*);
- Elementi i profilin të tokës (përfshirë *ShtresaETokës* dhe *HorizontetETokës*);
- Trupi i tokës;
- Objekti derivues i tokës;
- *MbulimiITokës* dhe *MbulimiPërshkruesITokës*;
- *SitToke*;
- *NgastërToke*.

Konceptet e profilin të vëzhguar të tokës dhe profilin derivues të tokës janë të paraqitura përmes klasave të *ProfiliIVëzhguarITokës* dhe *ProfiliIDerivuesITokës* janë nëntipa të klasës *ProfiliITokës*.

Profili i tokës

Një profil derivues i tokës është një profil i tokës i paraqitur me pikë, që merr vlerat e tiparit që derivojnë nga një ose disa profile të vëzhguara të tokës. Pavarësisht lidhjes që kanë nuk është e detyrueshme që profili derivues të marrë të gjitha të dhënat e profilin të tokës. Një profil derivues i tokës, mund të jetë një profil toke i pa gjeoreferencuar i cili nuk lidhet me një profil të vëzhguar të tokës dhe me tipare që kanë vlera.

Çdo profil i tokës mund të karakterizohet si një i vetëm, fal disa tipareve që janë të përfshira në model, si: tipi i tokës bazuar në skemën e klasifikimit të tokës sipas WRB:

- *EmërtimiITokësWRB* dhe/ose ndonjë lloj tjetër skeme klasifikimi për tokën.

- *EmërtimiTëTjerëTëTokës* me kufizimin e një emërtimi për një grup të dhënash, që paraqiten nga *ProfiliVëzhguesITokës* që është i lidhur me objektin *Vëzhgim*.

Përmes *TipariIVëzhguar*, objekti *Vëzhgim* krijon parametra, nga shtresa e attributeve të *FenomeniBazë* (vlerat merren nga kodlista *VleratEEmërtimeveTëParametraveTëProfilinTëTokës* dhe *Oum* (njësia matëse)). Nga rezultatet e lidhjes me objektin *Interval*, një vlerë i jepet parametrin; kjo vlerë duhet të jetë e tipit *Numër*, *LlojiIntervalit* (një vlerë e marrë nga intervali) ose *KarakterString*.

Shënim. Përdoruesi i kodlistës *VleratEEmërtimeveTëParametraveTëProfilinTëTokës* mund të shtoj të dhëna kur është e nevojshme.

Që të dhënat të kenë një ndërveprim rekomandohet të përdoret skema e klasifikimit WRB2. Ku me anë të *InspireId*, çdo profil toke mund të identifikohet nga një *IdentifikuesLokal*, i cili është një karakter string që lejon përcaktimin e objektit të profilin me çdo informacion që lidhet me të.

EmërtimiITokësWRB është pjesë e *EmërtimitTëTipitTëTokësWRB* që lejohet t'i japi *EmërtimitTëTokësWRB* një vlerë lidhur me strukturën WRB e cila përdoret dhe për disa

² WRB - The World Reference Base for Soil Resources - Baza Botërore e Referencës për Burimet e Tokës.



kodlista të tjera. Nëse një profil toke ka emërtimet e vjetra të WRB, përdorim atributin *EmërtimetTëTjeraTëTokës*.

Çdo rast i një *ProfilTëPërshkruarTëTokës* është i lidhur konkretisht me një rast *NgastërToke*, ku atributi *VendndodhjaENgastresëTëTokës* tregon vendndodhjen për të cilin të dhënat e tjera të tokës japin një përshkrim më të detajuar.

Shtresa e Tokës dhe Horizonti i Tokës

Çdo profil toke, qoftë i vëzhguar ose i derivuar, mund të përshkruhet nga horizontet dhe shtresat. Çdo horizont dhe shtresë mund të kenë një numër karakteristikash. Në model, shtresat dhe horizontet janë të përfaqësuar nga klasat *ShtresëToke* dhe *HorizontToke* të cilat janë nëntipat e klasës abstrakte *ElementetEProfilTëTokës*. Klasa abstrakte e *ProfilTëTokës* përmban një ose më shumë element të *ElementeTëProfilTëTokës*.

Një shtresë ose horizont karakterizohet nga një thellësi e sipërme dhe e poshtme, që tregon thellësinë e sipërme dhe të poshtme të horizontit apo të shtresës nga ngastra, atributi në klasën abstrakt *ElementiProfilTëTokës* që tregon thellësinë e horizontit ose shtresës është *IntervaliIThëllësisëSëElementitTëProfilTëTokës*.

Karakteristikat e horizonteve dhe shtresave janë modeluar përmes lidhjes së *VëzhgimiElementeveTëProfilTëTokës* me objektin *Vëzhgime*. Një horizont përcaktohet nga një emër horizonti sipas skemës së simboleve të horizonteve të FAO³-s nga 2006 (*HorizontetESimboleveFAO*) dhe/ose ndonjë skemë tjetër të simboleve të horizontit (*SimboleTëTjeraTëHorizontit*), me kufizim për një grup të dhënash. Një horizont korrespondon me një nënndarje horizontale të tokës bazuar në proceset pedogjenike.

Një shtresë korrespondon me një nënndarje të horizontit të tokës bazuar në kritere të tjera, përveç proceseve pedogjenike. Shtresa përcaktohet nga një emërtim që përcakton llojin e shtresës: horizont i sipërm, horizont i poshtëm, *ThëllësiaEIntervalit* ose gjeogjenetika, që modelohet përmes atributit *TipiIShtresës* në klasën *ShtresëToke*.

Horizont i sipërm dhe i poshtëm janë koncepte plotësuese, që përdoren për të adresuar *domein-in* e proceseve pedogjenike.

Intervalet e thellësisë janë të përdorur për të përcaktuar karakteristikat kimike, të tokës dhe lidhen shpesh me thellësinë që janë marrë mostrat.

Nëse *ShtresaTokë* i përket tipit gjeogjenik, ajo përshkruhet për shkak të origjinës jo pedogjenike, dhe mund të përshkruhet nga këto attribute:

- *ShtresaTipiShkëmbit* (jep informacion petrografik ose litologjik mbi llojin e shkëmbit që shtresa është e përbërë);
- *ShtresaGjendjaEProcesitSëGjenezës*;
- *ShtresaMjedisiGjenezës*;
- *ShtresaGjendjaEProcesitTëGjenezës*.

Përveç shtresës *GjendjaEProcesitTëGjenezës* kodlistat merren nga tema “*Gjeologjia*”, me të dhënat e përcaktuara.

Parametrat *ProfilITokës*, *ElementiProfilTëTokës* dhe *ObjektiDerivuesITokës* lidhen përmes *Vëzhgim*, i cili është i lidhur me procesin e *Vëzhgimit*.

Shembull: Nëse pH i tokës është matur në një tretësirë kripë, duhet të deklarohet lloji dhe përqendrimi i tretësirës së kripës, si dhe tretësira për porcionin e tokës dhe pajisja.

Trupi i Tokës

Zonat të cilat janë kufizuar gjeografikisht me një mbulesë toke mund të karakterizohen nga disa profile të derivuara të tokës, modeli konceptual paraqet ndërtimin e një klase *TrupiITokës*. Ajo përfaqëson një bashkësi të profileve të derivuar të tokës që përfaqëson tokat që kanë karakteristika të përbashkëta të *TrupiITokës*. Zona përcaktohet nga atributi *Gjeometria* i klasës *TrupiITokës*. Prania e një ose më shumë llojeve të tokës në një trup toke, modelohet nga lidhja me klasën *PraniaEProfilTëTokësDerivuesNëTrupinETokës*, që lejon përcaktimin e profilin të derivuar të tokës të përdorur për të përshkruar *TrupiITokës* (shprehur në %).

Shembull: Një *TrupToke* mund të përbëhet nga një tip kryesor toke (siç përshkruhet nga një profil derivues i tokës), dhe nga disa të tjera (të përshkruara nga profilet të tjera derivuese të tokës) që kanë karakteristika të ndryshme nga ajo kryesorja. Një profil toke derivues mund të përdoret për të përshkruar më shumë se një *TrupToke*.

Atributi *EmërtimiITrupiTëTokës* i klasës *TrupToke*, kryen një përshkrim të trupit, i cili mund të jetë i nevojshëm për ndërtimin e legjendave në hartë. *EmërtimiITrupiTëTokës* kontribuon në shpjegimin e njësive të hartografimit të hartës, ku

³ FAO - Food and Agriculture Organization - Organizata Ushqimore dhe Bujqësore.



metadatat lidhen me një bazë të dhënash, duke i dhënë një emërtim dhe shpjegim këtyre të fundit.

Shënim. Edhe pse gjeometria (shprehur me poligon) e një *TrupiToke* është e njohur (përfshirë këtu dhe zonën, shprehur në %), vendndodhja e saktë dhe modeli gjeohapësinor i çdo trupi toke nuk është i përcaktuar.

Objekti Derivues i Tokës

ObjektiDerivuesITokës është një objekt gjeohapësinor (p.sh: pikë, vijë, poligon) që përfaqëson një tipar në lidhje me token (duke përdorur lidhjen *VëzhgimiObjektitDerivuesTeTokës* me *Vëzhgim*) nga ku vlerat e tij përfitohen nga:

a) vlerat e tipareve të tokës të lidhura me profilet e vëzhguara të tokës;

b) çdo të dhënë tjetër ose informacioni të jashtëm në lidhje me modelin (Shembull: rasti i një tjetër *ObjektiDerivuesITokës* (informacion i brendshëm); mbulimi i tokës/të dhënat e klimë (informacion i jashtëm)).

Një koleksion i tillë i *ObjektiDerivuesITokës* përbën një hartë tematike të tokës. Metadata e lidhur me një skedar të tillë të dhënash jep detajet se si vlerat për atributet e *ObjektiDerivuesITokës* janë logaritur.

Atributi gjeometrik i *ObjektiDerivuesITokës* tregon llojin dhe vendndodhjen gjeografike të objektit (p.sh: një poligon ose një pikë). Nëpërmjet lidhjes *VëzhgimiObjektitDerivuesTeTokës* me objektin *Vëzhgim*, parametri është përcaktuar dhe i jepet një vlerë, në të njëjtën mënyrë si parametrat për profilet e tokës dhe elementet e profilit.

Parametri zgjidhet nga kodlista *VleratEEmërtimeveTeParametraveTeObjektitDerivuesTeTokës*, ku sipas nevojës përdoruesi mund të shtoj të dhëna.

Në objektin derivues të tokës, vlerat për parametrat që janë të lidhur me *Vëzhgim*, mund të jenë 0 ose mund të kenë vlera që kanë informacion plotësues. Ky informacion mund të jetë zero (nuk ka) në shumë attribute të *Vëzhgimit* nga ku vlerat janë të llojit *EmërtimetEVlerave*.

Klasa *EmërtimetEVlerave* siguron një vlerë të përgjithshme për atributet, gjithashtu kjo klasë ka dy attribute:

- *EmërtimiPërgjithshëm (datatype)* që jep shpjegimin e emërtimit të vlerës;
- Çdo *datatype* që siguron vlerën, duhet të plotësohet në mënyrë konkrete: p.sh me një numër.

Një grup të dhënash të *ObjektiDerivuesITokës* paraqitet nga pikat, vijat dhe poligonet, paraqitja me raster përfshihet në klasën *MbulimiITokës*.

Mbulimi i tokës dhe përshkrimi i mbulimit të tokës

Qëllimi i klasës *MbulimiITokës* është të sigurojë një strukturë për shkëmbimin e hartave tematike të Pedologjisë. Gjeometria është paraqitur si mbulim, i cili vepron si një funksion për kthimin e vlerave nga shtrirja e tij për pozicion gjeohapësinor brenda *domein-it*. Atributi *ParametriITokës* i përket klasës *LlojiParametriTeTokës* që lidhet me *EmërtimetEParametraveTeTokës*.

Shënim.

Kodlista

VleratEEmërtimeveTeParametrave mund të shtohet sipas nevojës së përdoruesit. Vlerat merren nga *IntervaliPercaktuar* ku mund të jenë: *Numër*, *LlojiIntervalit* ose *KarakterString*.

Nevoja për të lidhur mbulimet me njëri-tjetrin, ku vlerat marrin informacion shtesë nga njëra-tjetra, klasa *MbulimiITokës* ka një lidhje tjetër me *PërshkrimiIMbulimitTeTokës*.

PërshkrimiIMbulimitTeTokës ka të njëjtën shtrirje gjeohapësinore si *MbulimiITokës*. Atributi *ParametriPërshkruesITokës* i përket *LlojiParametravePërshkruesTeTokës*, dhe ai jep informacion shtesë në lidhje me mbulimet.

Sit toke dhe ngastër toke

Sit toke është një zonë gjeografike e madhe, pjesë më e madhe sesa toka që po kryhet vëzhgimi, ku kjo e fundit quhet ngastër toke. Pra siti, përfaqëson ngastrën në mënyrë gjeografike; pra atributi *Gjeometria* i klasës *SitToke* mund të paraqitet me poligon ose me pikë. Në studimin dhe monitorimin e përgjithshëm të tokës, i gjithë informacioni bashkohet në një sit dhe trajtohet sikur të jetë mbledhur në të njëjtën kohë. Qëllimi i vëzhgimit mund të jetë i përgjithshëm ose specifik.

Ngastra e tokës përfshihet në model për të siguruar llojin dhe vendndodhjen e profilit të vëzhguar të tokës. Një ngastër toke brenda një siti toke mund të jetë i një lloji të caktuar si: pusëtë, mostër, gropë prove dhe vendndodhja gjeografike e shprehur me pikë ose me emërtim.

Ngastra e tokës duhet të lidhet me një profil të vëzhguar të tokës.

Një sit toke paraqitet në model me klasën e *SitToke*, atributi i saj *QëllimiHetimitTeTokës* tregon qëllimin e hetimit:

- *StudimiPërgjithshëmITokës* (i përgjithshëm);
- *StudimiSpecifikITokës* (specifik).



Ky lloj informacioni mund të jetë i rëndësishëm për vlerësimin e të dhënave për të identifikuar ndikimin në sitet e përcaktuara.

Tiparet e mundshme të një siti toke janë modeluar përmes *SitTokeIVëzhguar* lidhur me objektin Vëzhgim, në të njëjtën mënyrë siç janë modeluar parametrat e profilin të tokës, ndryshimi i vetëm është se parametri merret nga kodlista *VleratEmërtimeveTëParametraveTëSitiTëTokës*.

Shënim. Kjo kodlistë mund të zgjerohet nga ofruesi i të dhënave, kur është e nevojshme.

Një ngastër toke paraqitet nga modeli i klasës *NgastërToke*. Një *SitToke* përfshin një ose më shumë *NgastërToke*. Një ngastër toke është një tipar i

LlojiINGastrësSëTokës dhe vendndodhja është e përcaktuar nga atributi *VendndodhjaENgastrësSëTokës* që mund të shprehet përmes koordinatave X,Y; nga një tekst përshkruar ose një identifikues.

Shënime mbi vëzhgimet

Në skemën e mëposhtme, të gjitha informacionet që lidhen me vëzhgimet janë konsideruar si të dhëna të vlerave të tiparit për të cilin kemi interes. Këto të dhëna janë të lidhura me *feature-at* që kemi interes. Në standardin e temës “Pedologjia”, kërkimet lidhen me *ProfilinITokës*, *ObjektinDerivuesITokës*, *SitiITokës* që në rastin tonë, janë *featureType* me interes.




Figura 6: Diagrami UML i Pedologjisë – paraqitja vektor




Figura 7: Diagrami UML i Pedologjisë – Paraqitja e mbulumit




Figura 8: Paraqitja e datatype për Pedologjinë




Figura 9: Diagrami i kodlistave për Pedologjinë




Figura 10: Diagrami përmbledhës i Pedologjisë



3.1.3 Katalogu i tipologjisë

3.1.3.1 Lloji WRB i emërtimeve të tokës

-- Emri --

Emri i tipit të tokës sipas WRB i emërtimeve të tokës

-- Përkufizimi --

Identifikimi i profilit të tokës sipas WRB 2006, përditësimi i parë 2007, raportet e burimeve botërore të tokës nr. 103, FAO, Romë.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATTRIBUTE

◆ *GrupetEReferencësSëTokësWRB: VleratReferencëTëGrupeveTëTokësWRB*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Grupet referuese të tokës WRB

-- Përkufizimi --

Niveli i parë i klasifikimit të WRB.

-- Përshkrimi --

GrupetEReferencësSëTokës dallohen nga prania (ose mungesa) e horizonteve diagnostikues specifik, vetive dhe/ose materialeve. Shënim. Sistemi i klasifikimit të tokës sipas WRB përfshin 32 RSG të ndryshme.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *GrupiKualifikuesWRB: LlojetEGrupeveKualifikuesWRB*

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Grupi kualifikues WRB

-- Përkufizimi --

Tipi i të dhënave që përcakton një grup kualifikues dhe specifikuesit e tij të mundshëm, vendin dhe pozicionin që i takon atij në lidhje me *GrupetEReferencësSëTokësWRB*.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *KlasifikimiOriginal: Boolean*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Klasifikimi origjinal

-- Përkufizimi --

Vlera boolean që tregon nëse sistemi i klasifikimit WRB është sistem klasifikimi origjinal, për të përshkruar profilin e tokës.

-- Përshkrimi --

Tregon nëse toka e emëruar sipas WRB është përcaktuar në fushën (ose për profilet derivate gjatë procesit origjinal të derivimit), ose është përshtatur, ndryshuar apo riemëruar në bazë të përshkrimit origjinal të tokës. Ky informacion është i vlefshëm për përcaktimin e cilësisë së të dhënave.

[I detyrueshëm: PO]

LIDHJE

◆ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: *Sipër (DataType) LlojiWRBIEmërtimeveTëTokës «dataType»*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizimi --

Një lidhje që tregon se në klasifikimin WRB, një profil toke mbulon një profil tjetër të zhvilluar, më të vjetër.

Objektivi: *(DataType) LlojiWRBIEmërtimeveTëTokës «dataType»*

◆ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: *Sipër (DataType) LlojiWRBIEmërtimeveTokës «dataType»*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizimi --

Një lidhje që tregon se në klasifikimin WRB, një profil i tokës mbulon një profil tjetër të zhvilluar, më të vjetër.

Objektivi: *(DataType) LlojiWRBIEmërtimeveTokës «dataType»*



3.1.3.2 Elementi i profilit

-- Emri --

Elementi i profilit

-- Përkufizimi --

Një lloj objekti gjeohapësinor abstrakt, i grupimit të shtresave të tokës dhe/ose horizonteve për qëllime funksionale/operacionale.

-- Përshkrimi --

Elementi i profilit është termi i përgjithshëm, që përdoret për horizontet dhe shtresat.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

← Agreguar nga «*featureType*» *ElementiIProfil* te «*featureType*» *ProfilITokës*

LIDHJE STRUKTURORE TË BRENDSHME

→ Gjeneralizuar nga «*featureType*» *ShtresaETokës* te «*featureType*» *ElementiIProfil*

→ Gjeneralizuar nga «*featureType*» *HorizontITokës* te «*featureType*» *ElementiIProfil*

ATTRIBUTE

◆ *FillimiICiklitJetësor*: Datë – orë

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *InspireId*: Identifikues

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Inspire Id

-- Përkufizimi --

Identifikuesi i objektit të jashtëm të elementit të profilit.

-- Përshkrimi --

Shënim. Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues i veçantë i objektit i publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit në realitet.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *IntervaliIThëllësisëSëProfilITëElementit*: LlojiIntervalit

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Intervali i thellësisë së profilit të elementit

-- Përkufizimi --

Thellësia e sipërme dhe e poshtme e profilit të elementit (shtresa ose horizonti) e matur nga sipërfaqja (0 cm) e profilit të tokës (në cm).

-- Përshkrimi --

Intervali i thellësisë përbëhet nga thellësia mesatare (e sipërme dhe e poshtme) e pamjes së profilit të elementit nga ngastra.

Shënim. Shumica e kufijve të tokës janë zona të tranzicionit dhe jo linja të ndarjes. Përmasa mesatare e kufijve të sipërm dhe thellësia mesatare e kufijve të poshtëm të secilit element të profilit jepen në centimetra, të matura nga ngastra (duke përfshirë mbulesat organike dhe minerale) të tokës poshtë, pra të gjitha vlerat e thellësisë janë numra pozitivë.

Shënim. H horizonti 0–5 cm, A horizont 5–30 cm, B horizont 30–80 cm.

Shënim. Rregullat e mëposhtme duhet të merren parasysh:

- *VleratEPoshtme* dhe *VleraESipërme*: duhet të jenë vlera pozitive;

- Vlera e sipërme është thellësia nga maja e elementit (p.sh. 20);

- Vlera e poshtme është thellësia e pjesës fundore të elementit (p.sh. 40);



ATTRIBUTE

- Nëse tregohet vetëm vlera e sipërme: supozohet se vlera e ulët është e panjohur; kjo është e mundur vetëm për shtresën ose nivelin më të thellë të një profili;

- Nëse tregohet vetëm *VleraEPoshtme*: supozohet se *VleraESipërme* është e barabartë me 0, dhe kështu intervali është midis 0 dhe vlerës së *VleraEPoshtme*.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *MadhësiaEFraksionitTëGrimcave: LlojiIFraksionitTëMadhësisëSëGrimcave*

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Madhësia e fraksionit të grimcave

-- Përkufizimi --

Pjesa minerale e tokës, e ndarë në bazë të madhësisë (diametrit) së grimcave. Tregon se sa prej materialit mineral të tokës përbëhet nga grimcat me madhësi të specifikuar.

-- Përshkrimi --

Burimi: NRCS (Shërbimi i Ruajtjes së Burimeve Natyrore), manual i informatave të laboratorit të vëzhgimit të tokës. Raporti i hetimit të anketës së tokës nr. 45, versioni 1.0, maj 1995.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *PërfundimiICiklitJetësor: Datë – orë*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërhoq në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

LIDHJE

◆ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *ElementiIProfilit «featureType»*

Objektivi: «voidable» *VëzhgimiIElemntëveTëProfilit* (Class)
OM_Vëzhgim «FeatureType»

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Vëzhgimi i elementeve të profilin

-- Përkufizimi --

Vëzhgimi i një tipari të tokës, për karakterizimin e elementit të profilin (shtresa ose horizonti).

3.1.3.3 Llojet e simboleve të horizonteve FAO

-- Emri --

Llojet e simboleve të horizonteve të FAO

-- Përkufizimi --

Një klasifikim i një horizonti sipas sistemit të klasifikimit të horizontit të specifikuar në Udhëzimet për përshkrimin e tokës, edicioni i katërt, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë; UN2006.

-- Përshkrimi --

Një sistem kodik që tregon horizontet në të cilat të njëjtat procese dominuese të formimit të tokës kanë qenë aktive. Ky kod përmbledh shumë vëzhgime të përshkrimit të tokës dhe jep një paraqitje në lidhje me proceset gjenetike që kanë formuar tokën.

Shënim. Simboli i horizontit sipas FAO (2006) është një kombinim i disa simboleve:

- një numër që jep informacion rreth ndërprerjeve, domethënë, llojshmëria e materialit mbi bazën e të cilës është formuar toka, e llogaritur nga ngastra e tokës, por jo për materialin fillestar;

- një ose dy shkronja të mëdha që tregojnë tipin e horizontit kryesor (ose horizontit e kalimtar), të ndara nga një “/”;

- shkronjat e vogla të shtypit tregojnë karakteristikat vartëse të horizontit;

- një numër që tregon nëndarjet horizontale të pjesëve të horizontit të përcaktuar;



- një numër primar që mundëson dallimin e dy horizonteve që kanë të njëjtin emër, por të formuar në cikle të ndryshme të pedogjenezës.

-- **Tipi i elementit** --

DataType

ATTRIBUTE
<i>KlasifikimiOriginalFAO: Boolean</i> Shumëllojshmëria: [1] -- Emri -- Klasifikimi fillestar -- Përkufizimi -- Vlera boolean për të treguar nëse simboli i horizontit të FAO është origjinal për të përshkruar horizontin. -- Përshkrimi -- Tregon nëse simboli i horizontit është përcaktuar në terren (ose në profilet derivuese të tokës), ose është adaptuar, ndryshuar, ose caktuar në bazë të përshkrimit origjinal të horizontit. Këto të dhëna mund të përdoren për të shprehur cilësinë e të dhënave. [I detyrueshëm: PO]
<i>HorizontiKryesorFAO: VleratKryesoreFAOTëHorizonteve</i> Shumëllojshmëria: [1] -- Emri -- Horizonti kryesor FAO -- Përkufizimi -- Simbol i pjesës kryesore të horizontit. -- Përshkrimi -- Burimi: Udhëzimet për përshkrimin e tokës (botimi i katërt) FAO 2006, f. 67. [I detyrueshëm: PO]
<i>HorizontiVertikalFAO: Integer</i> Shumëllojshmëria: [0..1] -- Emri -- Horizonti vertikal FAO -- Përkufizimi -- Rendit numrin e nënndarjes vertikale në horizont. -- Përshkrimi -- Numri përdoret për të treguar nënndarjen horizontale të një horizonti të identifikuar, nga një grup i vetëm shkronjash në bazë të strukturës, teksturës, ngjyrës etj. Numri 1 përdoret për të përcaktuar pjesën e sipërme të horizontit. Numri 2 është pjesë e horizontit të vendosur poshtë etj. Nëse nuk bëhet nënndarje horizontale, nuk vendoset asnjë numër. Shënim. Përdorimi i fjalës vertikale është abstrakte sepse horizontet janë të ndara në dy ose më shumë se dy nënndarje horizontesh. Vertikaliteti shpreh rendin e drejtimit. Udhëzime për përshkrimin e tokës (botimi i katërt), Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë UN, Romë, 2006. [I detyrueshëm: PO]
<i>HorizontVartësFAO: VleratVartëseFAOTëHorizonteve</i> Shumëllojshmëria: [0..*] -- Emri -- Horizont vartës -- Përkufizimi -- Përcaktimet e dallimeve dhe karakteristikave vartëse brenda horizonteve dhe shtresave kryesore bazohen, në karakteristikat e vëzhguara në terren dhe aplikohen gjatë përshkrimit të tokës në vend. -- Përshkrimi -- Shkronjat e vogla përdoren si prapashetë, për të treguar llojet e veçanta të horizonteve, shtresave dhe karakteristikave të tjera. Burimi: Udhëzimet për burimet për përshkrimin e tokës, edicioni i 4-t, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë UN, Romë, 2006, tabela 85. [I detyrueshëm: PO]
<i>NumratPrimarFAO: VleratPrimareFAO</i>



ATTRIBUTE

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Numrat primar FAO

-- Përkufizimi --

Numrat primar të thjeshtë ose të plotë mund të përdoren për të treguar simbolin e horizontit kryesor më të ulët, të dy-tre horizonteve që kanë "prefix" numra arab dhe kombinime shkronjash.

-- Përshkrimi --

Përcaktimet e njëta mund të jenë të përshtatshme për dy ose më shumë horizonte ose shtresa të ndara, nga të paktën një horizont ose një shtresë të një lloji të ndryshëm në të njëjtin pedon. Sekuenca A-E-Bt-E-Btx-C është një shembull - toka ka dy horizonte E. Për ta bërë më të lehtë komunikimin, një numër primar përdoret me simbolin e horizontit kryesor të dy horizontet më të ulëta që kanë emërtime identike: AE-Bt-E'-Btx-C. Numri primar përdoret për përcaktimin e shkronjës së madhe dhe çdo simbol i vogël ndjek atë: B't. Numër primar nuk përdoret nëse të gjitha shkronjat e emërtimeve, të dy shtresave të ndryshme nuk janë identike. Numri primar mund të përdoret për të dyja llojet e tokave mineralet ose organike.

Burimi: Udhëzime për përshkrimin e tokës, edicioni i 4-t, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë; UN, Romë, 2006.

[I detyrueshëm: PO]

ShkëputjaEHorizonteveFAO: Integer

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Shkëputja e horizonteve FAO

-- Përkufizimi --

Numri i përdorur për të treguar një ndërprerje në horizont.

-- Përshkrimi --

Në tokat minerale, numrat arabë përdoren si parashtesë për të treguar ndërprerjet. Kudo që të jetë e nevojshme, ato përdoren para A, E, B, C dhe R. Ata nuk përdorin I dhe W, megjithëse këto simbole tregojnë qartë një ndërprerje. Këto parashtesa dallohen nga numrat arabë të përdorur si prapashtesë për nënndarjet vertikale.

Një ndërprerje është një ndryshim i rëndësishëm në shpërndarjen e madhësisë së grimcave ose të mineralogjisë që tregon ndryshimin në materialin nga i cili krijohen horizontet, ose një ndryshim i rëndësishëm në moshë, përveç në rasti kur moshja tregohet nga prapashtesa B. Simbolet për të identifikuar shkëputjet përdoren vetëm kur ato kontribuojnë konsiderueshëm për përshkuesit e profileve në kuptueshmërinë e lidhjeve midis horizonteve. Shtresëzimi i zakonshëm në tokat e formuara nga aluvionet nuk është përcaktuar si ndërprerje nëse shpërndarja e madhësisë së grimcave nuk ndryshon dukshëm nga shtresa në shtresë edhe pse horizontet gjenetike janë formuar në shtresat e kundërta. Kur një tokë është formuar tërësisht në një lloj materiali, një parashtesë nuk hiqet nga simboli; i gjithë profili është material 1. Në mënyrë të ngjashme, materiali në pjesën e sipërme të profilin që ka dy ose më shumë materiale të ndryshme është e kuptueshme që i përket materiali 1, por numri hiqet. Numërimi fillon me shtresën e dytë të materialit të ndryshëm, i cili është përcaktuar. 2. Shtresat e ndryshme numërohen rresht.

Burimi: Udhëzime për përshkrimin e tokës, edicioni i 4-t, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë; UN, Romë, 2006.

Shënim. Mosfunksionimi mund të ndodhi midis dy shtresave gjeogjenike.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.4 Llojet e tjera të emërtimeve të tokës

-- Emri --

Llojet e tjera të emërtimeve të tokës

-- Përkufizimi --

Një identifikim i profilin të tokës sipas një skeme të veçantë të klasifikimit.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATTRIBUTE

EmërtimiITokës: VleratELlojeveTëTjeraTëEmërtimeveTëTokës

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Emërtimi i tokës.

-- Përkufizimi --

Emërtimi i profilin të tokës sipas një skeme specifike klasifikimi.

[I detyrueshëm: PO]

KlasifikimiOriginal: Boolean

**ATTRIBUTE**

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Klasifikimi origjinal

-- Përkufizimi --

Vlera boolean tregon nëse sistemi i simboleve të horizonteve të specifikuar është sistemi origjinal i simboleve për të përshkruar horizontet. Këto të dhëna mund të përdoren për të shprehur cilësinë e të dhënave.

-- Përshkrimi --

Tregon nëse simboli i horizontit është përcaktuar në terren (ose në profilet e derivuara të tokës), ose është adaptuar, ndryshuar, ose caktuar në bazë të horizontit origjinal të përshkruar më vonë.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.5 Llojet e tjera të simboleve të horizonteve**-- Emri --**

Llojet e tjera të simboleve të horizonteve

-- Përkufizimi --

Klasifikimi i një horizonti sipas një sistemi të veçantë të klasifikimit.

-- Përshkrimi --

Një sistem kodik që tregon horizontet në të cilat, të njëjtat procese dominuese tokë formuese kanë qenë aktive në të njëjtën mënyrë. Ky kod përmbledh shumë vëzhgime të përshkrimit të tokës dhe jep një pikëpamje në lidhje me proceset gjenetike që kanë ndodhur në tokë.

-- Tipi i elementit --*DataType***ATTRIBUTE**
KlasifikimiOrigjinal: Boolean

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Klasifikimi origjinal

-- Përkufizimi --

Vlera "Boolean" tregon nëse sistemi i simboleve të horizonteve të specifikuar është sistemi origjinal i simboleve për të përshkruar horizontin. Këto të dhëna mund të përdoren për të shprehur cilësinë e të dhënave.

-- Përshkrimi --

Tregon nëse simboli i horizontit është përcaktuar në terren (ose është marrë nga profilet e tokës gjatë burimit origjinal), ose është përshtatur, ndryshuar ose caktuar në bazë të përshkrimit të horizontit origjinal.

[I detyrueshëm: PO]

SimboletEHorizonteve: VleratELlojeveTëTjeraTëSimboleveTëHorizonteve

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Simboli i horizontit

-- Përkufizimi --

Simboli që karakterizon horizontin e tokës sipas një sistemi të specifikuar klasifikimi.

-- Përshkrimi --

Shënim. Kjo quhet gjithashtu dhe vlera e përcaktimit të horizontit ose simboli i horizontit.

Shëmbull: "ss" tregon sipërfaqen e një krisjeje të krijuar në tokë që përmban sasi të madhe të argjilës.

Simbolet në disa sisteme klasifikimi mund të jenë të njëjtë si: "Ap" është një horizont A i cili është lëruar.

[I detyrueshëm: PO]



3.1.3.6 Lloji i fraksionit të madhësisë së grimcave

-- Emri --

Lloji i fraksionit të madhësisë së grimcave

-- Përkufizimi --

Pjesa e tokës që është e përbërë nga grimcat minerale të tokës brenda një rangu madhësie të përcaktuar.

-- Përshkrimi --

Pjesa minerale e tokës, e ndarë në bazë e kufirit të madhësisë (diametrit), së grimcave. Ajo është fraksioni më i imët i tokës. Për të qenë më të saktë, grimcat e tokës kalojnë në një sitë me diametër 2mm. Shpërndarja e madhësisë së kokrrizës (ose grimcave) karakterizon materialin mineral të tokës, bazuar në ndarjen ekuivalente të secilës klasë të diametrit ekuivalent të grimcave individuale.

Burimi 1: NRCS⁴ Shërbimi i Ruajtjes së Burimeve Natyrore, manuali informativ i laboratorit të sondazhit të tokës, raporti i hetimit të anketës së tokës nr. 45, versioni 1.0, maj 1995, f. 11

Burimi 2: Fjalor për shprehjet në lidhje me shkencën e tokës.

-- Tipi i elementit --

Data Type

ATTRIBUTE

IntervaliIFraksionitTëMadhësisëSëGrimcave: LlojiIntervalit

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Intervali i fraksionit të madhësisë së grimcave

-- Përkufizimi --

Intervali (kufiri i sipërm dhe i poshtëm) i madhësisë së grimcave të fraksionit të përcaktuar (shprehur në µm).

-- Përshkrimi --

Burimi: NRCS Shërbimi i ruajtjes së burimeve natyrore, manuali i informacionit i laboratorit të studimit të tokës, raporti i studimit të tokës nr. 45, versioni 1.0, maj 1995, f. 11.

Shembull: Kufiri i sipërm = 63µm; Kufiri i poshtëm = 20µm.

[I detyrueshëm: PO]

PërmbajtjaEFraksionit: Numër

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Përmbajtja e fraksionit

-- Përkufizimi --

Përqindja (%) e fraksionit të përcaktuar.

-- Përshkrimi --

Burimi: NRCS Shërbimi i ruajtjes së burimeve natyrore, manuali i informacionit i laboratorit të studimit të tokës, raporti i studimit të tokës nr. 45, versioni 1.0, maj 1995 f. 11.

Shënim. Shuma e përqindjeve (%) të të gjitha fraksioneve duhet të jetë 100%.

Shembull: Vlera e përqindjes (pesha/pesha).

[I detyrueshëm: PO]

⁴ NRCS - Natural Resources Conservation Service - Shërbimi i Ruajtjes së Burimeve Natyrore.



3.1.3.7 Lloji i intervalit

-- Emri --

Lloji i intervalit

-- Përkufizimi --

Vlera e intervalit të përcaktuar nga kufiri i sipërm dhe kufiri i poshtëm.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATTRIBUTE

◆ *Uom: NjësiaMatëse*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Njësi matëse

-- Përkufizimi --

Njësia e matjes që përdoret për të shprehur vlerat e intervalit.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *VleraEPoshtme*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Vlera e poshtme

-- Përkufizimi --

Vlera që përcakton kufirin e poshtëm të një karakteristike të caktuar.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *VleraESipërme*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Vlera e sipërme

-- Përkufizimi --

Vlera që përcakton kufirin e sipërm të një karakteristike të caktuar.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.8 Lloji i parametrave të tokës

-- Emri --

Lloji i parametrave të tokës

-- Përkufizimi --

Një karakteristikë e lidhur me tokën (tema “*Pedologjia*”) që përfaqësohet nga ky mbulim. Karakteristika paraqitet nga një emër parametri, që merret nga një kodlistë. *VleraEEmërtimeveTëParametraveTëObjekteveDerivueseTëTokës* dhe njësia matëse, përdoren për të shprehur parametrin.

-- Përshkrimi --

Shembull: Përshtatshmëria e tokës për ujitje, pH në horizontin e sipërm etj.

-- Tipi i elementi --

DataType

ATTRIBUTE

◆ *EmërtimiIParametritTëTokës: VleratEEmërtimeveTëParametraveTëObjekteveDerivueseTëTokës*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Emërtimi i parametrave të tokës.

-- Përkufizimi --

Emërtimi i parametrave të tokës marrë nga *MbulimiITokës*.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *Uom*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

**ATTRIBUTE**

Njësia matëse

-- Përkufizimi --

Njësia matëse që përdoret për të shprehur parametrin e tokës.

-- Përshkrimi --Shembull: Për të shprehur *ParametriITokës* “thellësia e horizontit B”, përdorim cm.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.9 Lloji i parametrave përshkrues të tokës**-- Emri --**

Lloji i parametrave përshkrues të tokës

-- Përkufizimi --

Tipi i të dhënave që siguron një përshkrim në lidhje me cilësitë e tokës (tema “*Pedologjia*”) dhe përfaqësohet nga *MbulimiITokës*.

-- Përshkrimi --Ky *datatype* ka një emër dhe nëse nevojitet njësia e matjes.Shembull: Niveli i sigurisë për secilën vlerë në *MbulimiITokës* (pH në shtresën e sipërme).**-- Tipi i elementit --***DataType***ATTRIBUTE**
EmërtimiParametravePërshkruesTëTokës: Tekst (CharacterString)

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Emërtimi i parametrave përshkrues të tokës

-- Përkufizimi --Emërtimi i parametrave për të siguruar më shumë informacion për vlerat e *MbulimiTëTokës*.**-- Përshkrimi --**

Shembull:

EmërtimiParametravePërshkruesTëTokës = niveli i sigurisë.*MbulimiITokës* = mbulesa që përfaqëson pH e shtresës së sipërme të tokës.

[I detyrueshëm: PO]

Uom: NjësiaMatëse

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Njësia matëse

-- Përkufizimi --Njësia matëse që përdoret për të shprehur *ParametratPërshkruesTëTokës*.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.10 Mbulimi i tokës**-- Emri --**

Mbulimi i tokës

-- Përkufizimi --

Një lloj objekti gjeohapësinor, që mbart vlera për një tipar, bazuar në një ose më shumë tregues/parametra të tokës dhe mundësisht të jenë brenda zonës së saj gjeohapësinore.

-- Përshkrimi --

Burimi: Përshtatur nga Mbulimi [SSH EN ISO 19123:2007].

-- Tipi i elementit --*FeatureType*



LIDHJE STRUKTURORE E JASHTME

← Gjeneralizuar nga «featureType» MbulimiITokës te «featureType» RrjetiKoordinativIRektifikuar(Transformuar)

ATTRIBUTE

◆ *FillimiICiklitJetësor: Datë-orë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave hapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *EVlefshmeNga: Datë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

E vlefshme nga

-- Përkufizimi --

E vlefshme nga, specifikon afatin kohor për të cilin janë marrë masat për të llogaritur cilësinë tematike të tokës që lidhet me atë periudhë. E vlefshme nga, përcakton kohën kur fillon periodha.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *KohaEVlefshmeEPërfundimit: Datë*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

E vlefshme deri

-- Përkufizimi --

E vlefshme deri, specifikon afatin kohor për të cilin janë marrë masat për të llogaritur cilësinë tematike të tokës që lidhet me atë periudhë. E vlefshme deri, përcakton kohën kur përfundon periodha.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *ParametriITokës: LlojiIParametraveTëTokës*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Parametri i tokës

-- Përkufizimi --

Një tipar i lidhur me tokën (për temën “Pedologjia”) që përfaqësohet nga mbulimi.

-- Përshkrimi --

Shembull: Përshtatshmëria e tokës për ujitje, pH në shtresën e sipërme etj.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *PërfundimiICiklitJetësor: Datë-orë*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Përfundimi ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërhoq nga grupi i të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *ShtirjeTerritoriale: EX_Shtirja*

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Shtirje territoriale

-- Përkufizimi --

Atributi *ShtirjeTerritoriale* do të përmbajë shtirjen territoriale gjeohapësinore të mbulimit. Lloji i të dhënave *Shtirje*, është përcaktuar në SSH EN ISO 19103:2015. Shtirjet mund të specifikohen në hapësirë dhe në kohë.

-- Përshkrimi --

Burimi: Përshtatur nga [SSH EN ISO 19123: 2007].

[I detyrueshëm: PO]

**LIDHJE**

Lidhje (drejtim: Objektivi-Burimi)

Burimi: Përshkruan (Class) *MbulimiITokës «featureType»*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Përshkrim

-- Përkufizimi --

Lidhja e tij lejon një *MbulimToke* të ketë një mbulim të lidhur, i cili nuk ka kuptim pa mbulimin bazë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Një mbulim i pH-së së shtresës së punueshme lidhet me mbulimin, saktësisht me të njëjtin nivel, dhe raportimin e terrenit në nivelin e sigurisë së vlerave të pH të mbulimit bazë.

Objekti: «voidable» *PërshkruhetNga* (Class)

PërshkrimiIMbulimitTëTokës «featureType»

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Përshkruhet nga

-- Përkufizimi --

Kjo lidhje lejon një *MbulimTëTokës* të ketë një mbulim të lidhur, i cili nuk ka kuptim pa mbulimin bazë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Një mbulim i pH-së së shtresës së lartë lidhet me mbulimin, saktësisht të njëjtin nivel, dhe raportimin e territorit në nivelin e besimit të vlerave të pH të mbulimit bazë.

3.1.3.11 Horizonti i tokës

-- Emri --

Horizonti i tokës

-- Përkufizimi --

Domein-i i një toke me një shtrirje të caktuar vertikale, pak a shumë paralele me sipërfaqen dhe homogjene për pjesën më të madhe të karakteristikave morfologjike dhe analitike, të zhvilluara në një shtresë materiali burimor përmes proceseve pedogjene ose të përbërë nga mbetjet organike të akumuluar nga masa vegjetative e bimëve (torfa).

-- Përshkrimi --

Horizonti mund të jetë pjesë e një shtrese.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE E JASHTME

Gjeneralizuar nga «featureType» *HorizontiITokës* te «featureType» *ElementiIProfil*

ATTRIBUTE

SimboletEHorizonteveFAO: LlojetESimboleveTëHorizonteveFAO

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Simbolet e horizonteve FAO

-- Përkufizimi --

Përcaktimi i horizonteve të tokës

-- Përshkrimi --

Simbolet e horizontit të FAO janë një sistem i kodifikuar që karakterizon horizontet në lidhje me proceset dominante të formimit të tokës që kanë qenë aktive gjatë formimit të horizontit.

Ky kod përmbledh shumë vëzhgime të përshkrimit të tokës dhe jep një paraqitje për proceset gjenetike që kanë ndikuar në formimin e tokës.

Shënim. Simboli i horizontit është një kombinim i disa shkronjave, numrave dhe simboleve. Udhëzimet për burimet për përshkrimin e tokës, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë, UN Romë, 2006.

Shembull: Me përcaktimin Bw: kuptojmë që horizonti B me një zhvillim të ngjyrës dhe/ose strukturës.

[I detyrueshëm: PO]

SimboletEHorizontitTëTjera: LlojetETjeraTëSimboleveTëHorizontit

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Simbolet e horizonteve të tjera

-- Përkufizimi --

**ATTRIBUTE**

Përcaktimi i horizontit të tokës sipas një sistemi të veçantë të klasifikimit.

-- Përshkrimi --

Një sistem kodik që karakterizon horizontet në lidhje me proceset dominuese të formimit të tokës që kanë qenë aktive gjatë formimit të horizontit. Ky kod përmbledh shumë vëzhgime të përshkrimit të tokës dhe jep informacion rreth proceseve gjenetike që kanë ndikuar në formimin e tokës.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.12 Objekti derivues i tokës**-- Emri --**

Objekti derivues i tokës

-- Përkufizimi --

Një lloj objekti gjeohapësinor, për përfaqësimin e objekteve gjeohapësinore, me tipare të lidhura me tokën që rrjedhin nga një ose më shumë tipare të tjera.

-- Përshkrimi --

Shënim. Hartat tematike mund të përftohen drejtpërdrejt nga baza e të dhënave për tokën (përmbajtja e lëndës organike, pH, tekstura etj.), ose mund të përftohen duke përdorur funksione pedotransfer ose rregullat e pedotransferit (p.sh. ujë i disponueshëm për bimët në thellësinë e rrënjës). Përftimi mund të jetë nxjerrja e thjeshtë nga një fushë e vetme e të dhënave, ose një kombinim kompleks i llojeve të ndryshme të të dhënave dhe aplikimet p.sh. matematikore ose procedurave të bazuara në ekspertë.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

ATTRIBUTE

Gjeometria: GM_Objekt

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Gjeometria

-- Përkufizimi --

Gjeometria që përcakton objektin e derivuar të tokës.

-- Përshkrimi --

Një përfaqësim gjeohapësinor i informacionit për tokën, bëhet i qartë duke përcaktuar zonat me vlera të ngjashme sipas tipit të tokës që përfaqësohet.

[I detyrueshëm: PO]

InspireId: Identifikues

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

InspireId

-- Përkufizimi --

Identifikuesi i objektit të jashtëm të *ObjektitDerivuesITokës*.

-- Përshkrimi --

Shënim. Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues i veçantë i objektit i publikuar nga organi përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i dukurisë në realitet.

[I detyrueshëm: PO]

LIDHJE

Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *ObjektiDerivuesITokës «featureType»*

Objektivi: «voidable» *BazuarNëVëzhgiminEProfilitTëTokës* (Class) *ProfilivëzhguarITokës «featureType»*

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Bazuar në vëzhgimin e profilin të tokës

-- Përkufizimi --

Lidhet me një profil toke të përshkruar mbi ato tipare



LIDHJE

që vlera e derivuar është bazuar.

-- Përshkrimi --

Objekti derivues i tokës mund të krijohet bazuar në cilësitë e tokës të një ose më shumë profileve toke të përshkruara. Nëse ky informacion nuk do të përfshihet ose nuk zbatohet, lidhja mund të jetë bosh.

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *ObjektiDerivuesITokës «featureType»*

Objekti: *«voidable» VëzhgimiObjekteveDerivueseITokës(Class) OM_Vëzhgimi «featureType»*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Vëzhgimi i objekteve derivuese të tokës

-- Përkufizimi --

Përshkrimi i një tipari të tokës për karakterizimin e objektit tokë të derivueshëm.

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *ObjektiDerivuesITokës «featureType»*

Objekti: *«voidable» BazuarNëObjektinDerivuesTëTokës (Class) ObjektiDerivuesITokës «featureType»*

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Bazuar në objektin derivues të tokës

-- Përkufizimi --

Lidhja me një objekt tokë të derivuar mbi ato tipare ku vlera e derivuar është bazuar.

-- Përshkrimi --

Një objekt tokë i derivuar mund të krijohet bazuar në vetitë e një ose më shumë objekteve të tjera që rrjedhin nga toka. Nëse ky informacion nuk do të përfshihet ose nuk zbatohet, lidhja mund të jetë bosh.

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *ObjektiDerivuesITokës «featureType»*

Objekti: *«voidable» BazuarNëTrupinETokës (Class) TrupiITokës «featureType»*

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Bazuar në trupin e tokës

-- Përkufizimi --

Lidhet me një trup toke në tiparet e të cilit bazohet vlera e nxjerrë.

-- Përshkrimi --

Objekti derivues i tokës mund të krijohet bazuar në vetitë e tokës të një ose më shumë trupave të tokës. Nëse ky informacion nuk do të përfshihet ose nuk zbatohet, lidhja mund të jetë bosh.

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *ObjektiDerivuesITokës «featureType»*

Objekti: *«voidable» BazuarNëObjektinDerivuesITokës (Class) ObjektiDerivuesITokës «featureType»*

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Bazuar në objektin derivues të tokës

-- Përkufizimi --

Lidhja me një objekt derivues të tokës në tiparet e të cilit bazohet vlera e nxjerrë.

**LIDHJE****-- Përshkrimi --**

Një objekt derivues i tokës mund të krijohet bazuar në vetitë e një ose më shumë objekteve të tjera që rrjedhin nga toka. Nëse ky informacion nuk do të përfshihet ose nuk zbatohet, lidhja mund të jetë bosh.

3.1.3.13 Prania e profilit derivues në trupin e tokës**-- Emri --**

Prania e profilit derivues në trupin e tokës

-- Përkufizimi --

Tregon përqindjet (kufiri i sipërm dhe i poshtëm) që profili derivues merr pjesë në trupin e tokës.

-- Përshkrimi --

Shënim 1. Trupi i tokës karakterizohet nga një ose më shumë profile derivuese të tokës, në një zonë gjeografike të përcaktuar. Kur trupi i tokës karakterizohet nga më shumë se një profil derivues, zona e shpërndarjes së këtyre profileve derivuese të tokës nuk është përcaktuar në mënyrë gjeohapësinore, por prania e tyre tregohet nga një sërë përqindjesh.

Shënim 2. Shuma e pjesëve kufitare më të ulëta nuk duhet të kalojë 100%.

Shënim 3. Nëse nuk përdoret një interval, por një përqindje specifike atëherë kufijtë e poshtëm dhe të sipërm janë të barabartë.

-- Tipi i elementit --

Lidhje

ATTRIBUTE

IntervaliNëPërqindjeIProfilidDerivues: LlojiIntervalit

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Intervali në përqindje i profilid derivues

-- Përkufizimi --

Interval që përcakton përqindjen minimale dhe maksimale të zonës së trupit të tokës, të përfaqësuar nga një profil derivues i veçantë i tokës.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.14 Profili derivues i tokës**-- Emri --**

Profili derivues i tokës

-- Përkufizimi --

Profil toke në një pikë të pa lokalizuar, që shërben si një profil orientues për një tip të veçantë të tokës, në një zonë të caktuar gjeografike.

-- Përshkrimi --

Karakteristikat e një profili toke derivues kanë kryesisht prejardhje (p.sh. e mesatarizuar) nga një ose disa profile të përshkruara në të njëjtin tip toke ose janë marrë në konsideratë njohuritë e ekspertit për të njëjtin lloj peizazhi.

Shënim 1. Profili derivues i tokës përfaqëson mesataren ose profilin tipik që karakterizon njësinë tipologjike të tokës, serinë e tokës.

-- Tipi i elementit --

FeatureType



LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

← Gjeneralizuar nga «featureType» ProfiliDerivuesITokës te «featureType» ProfiliITokës

LIDHJE

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *TrupiITokës* «featureType»

Objektivi: «voidable» *ËshtëEPërshkruarNga* (Class)
ProfiliDerivuesITokës «featureType»

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Është e përshkruar nga

-- Përkufizimi --

Lidhet me një profil derivues të tokës që karakterizon trupin e tokës, ndoshta në kombinim me profile derivuese të tjera të tokës. Lidhja ka tipare të tjera të përcaktuara në klasën e lidhjes *PraniaEProfilitDerivuesNëTrupinETokës*.

-- Përshkrimi --

Kjo lidhje përbën lidhjen me ato profile derivuese të tokës që informojnë për strukturën e brendshme dhe tiparet e trupit të tokës.

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: «voidable» *DerivuarNga* (Class) *ProfiliIVëzhguarITokës*

«featureType»

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Derivuar nga

-- Përkufizimi --

Lidhen me një ose më shumë profile të tokës të vëzhguara nga ku është nxjerrë ky profil.

-- Përshkrimi --

Një profil derivues i tokës mund të rrjedhë nga një në shumë profile të vëzhguara të tokës. Nëse asnjë profil i vëzhguar nuk është siguruar ose nuk është përdorur për të prodhuar profilin e *ProfiliDerivuesITokës*, kjo lidhje mund të lihet bosh.

3.1.3.15 Llojet e grupeve kualifikuese WRB

-- Emri --

Llojet e grupeve kualifikuese WRB

-- Përkufizimi --

Tipi i informacionit që përcakton grupet kualifikuese dhe specifikimin/et e mundshëm, vendndodhjen dhe pozicionin e tij në lidhje me *GrupetEReferencësSëTokës* (RSG) sipas WRB 2006, përditësuar 2007.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATTRIBUTE

◆ *KualifikuesiWRB: VleratKualifikueseWRB*

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Kualifikuesi WRB

-- Përkufizimi --

Nëse ka një ose më shumë kualifikues “*prefix*” një nga kualifikuesit është në pozitën 1, kualifikuesit e tjerë gjenden në pozicionin 2, 3 etj.; Pozita 1 është pozicioni më i afërt me RSG; Pozita 2 është pozicioni i dytë më i afërt me RSG; etj.

Nëse ka një ose më shumë kualifikues prapashtesë: një nga kualifikuesit është në pozicionin 1, kualifikuesit e tjerë gjenden në pozicionin 2, 3 etj. Pozita 1 është pozicioni më i afërt me RSG; Pozita 2 është pozicioni i dytë më i afërt me RSG; etj.

-- Përshkrimi --

**ATTRIBUTE**

Burimi: WRB 2006, përditësimi i parë 2007. Raportet e burimeve botërore të tokës nr. 103, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë UN, Romë, 2007.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *KualifikuesPozicioni: Integer*
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Kualifikues pozicioni

-- Përkufizimi --

Numër tregues për pozicionin e një kualifikuesi në lidhje me grupin e referencës WRB (RSG) që i përket dhe në lidhje me vendosjen e tij në RSG, si një prefix ose sufiks.

-- Përshkrimi --

Nëse ka një ose më shumë kualifikues “prefix”: një nga kualifikuesit është në pozitën 1, kualifikuesit e tjerë gjenden në pozicionin 2, 3 etj.; Pozita 1 është pozicioni më i afërt me RSG; Pozita 2 është pozicioni i dytë më i afërt me RSG; etj.

Nëse ka një ose më shumë kualifikues prapashtesë: një nga kualifikuesit është në pozicionin 1, kualifikuesit e tjerë gjenden në pozicionin 2, 3 etj.; Pozita 1 është pozicioni më i afërt me RSG; Pozita 2 është pozicioni i dytë më i afërt me RSG; etj.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *SpecifikuesiWRB: VleratPërcaktueseWRB*
Shumëllojshmëria: [0..2]

-- Emri --

Specifikuesi WRB

-- Përkufizimi --

Kodi që tregon shkallën e shprehjes së një kualifikuesi ose gamën e thellësisë për të cilin zbatohet kualifikuesi.

-- Përshkrimi --

Specifikuesit mund të përdoren për të treguar thellësinë e shfaqjes, ose për të shprehur intensitetin e karakteristikave të tokës. Shembull: Shtresat nëntokë përcaktohen nga specifikuesi “Thapto”.

Shënim 1. Kodi i specifikuesit shtohet gjithmonë pas kodit të kualifikimit. Përfashtimet janë të përcaktuara në listën e kualifikuesve të WRB.

Shënim 2. Disa specifikues mund të kombinohen me njëri-tjetrin për një kualifikues.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *VendiKualifikues: VleratEPozicioneveKualifikueseWRB*
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Vendi kualifikues

-- Përkufizimi --

Atribut që tregon vendosjen e kualifikuesit në lidhje me grupin e referencës WRB (RSG). Vendosja mund të jetë përpara RSG-së, pra *prefix* ose mund të jetë prapa RSG-së, sufiks.

[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.16 Profili i vëzhguar i tokës

-- Emri --

Profili i vëzhguar i tokës

-- Përkufizimi --

Një përfaqësim i një profili të tokës është gjetur në një vend të caktuar i cili përshkruhet në bazë të vëzhgimeve në një grupë prove ose në një pus.

-- Përshkrimi --

Profili i tokës i përshkruar korrespondon me një grup të dhënash të marra direkt nga një profil i gjeoreferencuar i tokës, i përshkruar në terren, dhe shpesh janë marrë mostrat dhe janë analizuar në laborator.

-- Tipi i elementit --

FeatureType



LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

← Gjeneralizuar nga «featureType» ProfiliIVëzhguarITokës te «featureType» ProfiliITokës

LIDHJE

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: «voidable» ProfiliIVëzhguar (Class) ProfiliIVëzhguarITokës Objektivi: Vendndodhje (Class) NgastërToke «featureType»
«featureType» Shumëllojshmëria: [1]

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Profili i vëzhguar

-- Përkufizimi --

Vendndodhje

-- Përkufizimi --

Vendndodhja e një profili të vëzhguar është ngastra e

Lidhet me profilin e tokës i përshkruar për të cilin ngastra e tokës tokës.

siguron informacion mbi vendndodhjen.

-- Përshkrimi --

Ngastra e tokës është vendi në të cilin është vëzhguar profili.

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: «voidable» DerivuarNga (Class) ProfiliIVëzhguarITokës Objektivi: «voidable» (Class) ProfiliDerivuesITokës
«featureType» «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*]

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Derivuar nga

-- Përkufizimi --

Lidhen me një ose më shumë profile toke të përshkruara nga ku është nxjerrë ky profil.

-- Përshkrimi --

Një profil derivues toke mund të rrjedhë nga një në shumë profile të tokës të përshkruara. Nëse asnjë profil i përshkruar nuk është siguruar ose nuk është përdorur për të prodhuar profilin e ProfiliDerivuesITokës, kjo lidhje mund të lihet bosh.

✍ Lidhje (drejtim: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) ObjektiDerivuesITokës «featureType»

Objektivi: «voidable» BazuarNëVëzhgiminEProfilITokës (Class) ProfiliIVëzhguarITokës «featureType»

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Bazuar në vëzhgimin e profilin tokës

-- Përkufizimi --

Lidhet me një profil të vëzhguar të tokës mbi tiparet e të cilave, bazohet vlera e nxjerrë.

-- Përshkrimi --

Objekti derivues i tokës mund të krijohet bazuar në vetitë e tokës të një ose më shumë profileve të vëzhguara të tokës. Nëse ky informacion nuk do të përfshihet ose nuk zbatohet, lidhja mund të jetë bosh.

3.1.3.17 Profili i tokës

-- Emri --

Profili i tokës

-- Përkufizimi --

Përshkrimi i tokës karakterizohet nga një vazhdimësi vertikale e elementeve të profilin.

-- Përshkrimi --

Shënim. Profili i tokës përfitohet nga vëzhgimet në një grupë prove, ose duke përdorur profile të tjera të tokës, kjo e fundit kërkon ndihmën e ekspertëve.



LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

- Agreguar nga «featureType» ElementiProfilit te «featureType» ProfiliITokës
- Gjeneralizuar nga «featureType» ProfiliDerivuesITokës te «featureType» ProfiliITokës
- Gjeneralizuar nga «featureType» ProfiliVëzhguarITokës te «featureType» ProfiliITokës

ATRIBUTET

◆ *Emërtime të tjera të tokës: llojet e tjera të emërtimeve të tokës*

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- **Emri** --

Emërtime të tjera të tokës

-- **Përkufizimi** --

Identifikimi i profilit të tokës sipas një skeme të veçantë të klasifikimit.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *Emërtimet WRB të tokës: Lloji WRB i emërtimeve të tokës*

Shumëllojshmëria: [1]

-- **Emri** --

Emërtimet WRB të tokës

-- **Përkufizimi** --

Identifikimi i profilit të tokës

-- **Përshkrimi** --

Shënim. Struktura e *Lloji i Emërtimeve WRB të tokës* bazohet në WRB 2006, përditësimi i parë 2007. Raportet e burimeve botërore të tokës nr. 103. Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë; UN, Romë 2007.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *E vlefshme nga: Datë – orë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- **Emri** --

E vlefshme nga

-- **Përkufizimi** --

Koha kur dukuria fillon të ekzistoj.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *Fillimi i ciklit jetësor: Datë – orë*

Shumëllojshmëria: [1]

-- **Emri** --

Fillimi i ciklit jetësor

-- **Përkufizimi** --

Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *Identifikuesi lokal: Tekst (Character String)*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --

Identifikuesi lokal

-- **Përkufizimi** --

Identifikues unik i profilit të tokës jepet nga mbajtësi i të dhënave.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *InspireId: Identifikues*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --

InspireId

-- **Përkufizimi** --

Identifikuesi i objektit të jashtëm të profilit të tokës.

-- **Përshkrimi** --

Shënim. Identifikuesi i objektit të jashtëm është një identifikues unik i objektit, i publikuar nga organi përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit

**ATRIBUTET**

gjeohapësinor, jo i një dukurie në realitet.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *I vlefshëm deri: Datë – orë*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

I vlefshëm deri

-- Përkufizimi --

Koha nga e cila dukuria nuk ekziston më në realitet.

[I detyrueshëm: PO]

◆ *Përfundimi i ciklit jetësor: Datë – orë*

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --

Përfundimi ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërhoq nga grupi i të dhënave gjeohapësinoe.

[I detyrueshëm: PO]

Lidhje

✍ Lidhje (drejtimi: Objektivi-burimi)

Burimi: (Class) *Profili i tokës* «featureType»

Target: «voidable» *Vëzhgimi i profilit të tokës* (Class)

OM_ *Vëzhgim* «featureType»

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Vëzhgimi i profilit të tokës

-- Përkufizimi --

Vëzhgimi i një toke për të përcaktuar karakteristikat e profilit të tokës.

